REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E TË ARDHURAVE, LEJAVE, LIÇENSAVE DHE BORXHIT

Nr_____Prot Bilisht më _____, _____, 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 67 datë 20/ 11 /2025

PER MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE TE BASHKISE DEVOLL PER VITIN 2026

Bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore " i ndryshuar, ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligji nr.9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit ",I ndryshuar, ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, V.K.M nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesa,bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit të të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" i ndryshuar. Ligji Nr.29/2023 "Për Tatimin mbi të ardhurat "I ndryshuar, ligji Nr.10081 datë 23.02.2009 "Për licencat,autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Ligji Nr.9975 datë 28.07.2008 " Për Taksat Kombëtare " i ndryshuar. Ligji Nr.20/2020 "Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.107/2014 datë 31.07.2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit " i ndryshuar. Ligji Nr.10465 datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr.10279 datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative" Ligji Nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar. V.K.M. Nr.179 datë 09.03.2016 "Për miratimin e statutit të Qëndres kombëtare të Regjistrimit". V.K.M Nr.783 datë 10.11.2011 "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njesitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar,V.K.M Nr.54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve,dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shteterore" i

ndryshuar.V.K.M Nr.559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytezim, përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike , dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre I ndryshuar. V.K.M Nr.607 datë 29.07.2020 "Për tarifat e për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi I mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi I ndryshuar" Ligjit Nr.68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjin Nr.152/2015 datë 21.12.2015 " Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi ", Ligji Nr.24/2017 " Për administrimin e Ujitjes dhe Kullimit" , VKM Nr.319 datë 31.05.2018 " Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve ".

PROPOZOJ:

1. Të miratojë sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026 sipas materialit bashkëngjitur.
2. Të përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore , vetëm individi që i përket këtyre shtresave shoqërore të mëposhtme:
   a. Invalidët e punës
   b. Të verbërit
   c. Paaftësia
   d. Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët
3. Përjashtimin nga pagesa e taksave dhe tarifave të biznesit për vitin e parë për personat e komunitetit Rom dhe Egjiptian .
4. Të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt shfuqizohen.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha strukturat e Bashkisë Devoll që preken nga Paketa Fiskale 2026 .
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 datë17.12.2015 " Për vetqeverisjen Vendore "

Hartoi

Përgjegjës i Sektorit të Kontabilizimit të Ardhurave dhe Borxhit

Gazmend Malo

Përgjegjës Inspektoriati Tatimor,Kundravajtjeve Administrative

Ilir Duci

Drejtor Drejtoria e të Ardhurave Lejave Liçensave dhe Borxhit

Bledar Kanina

Konfirmon bazueshmërinë ligjore

Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve

Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISE

EDUARD DURO

Adresa:Bashkia Devoll,Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9,Tel& Fax +355811238l5-22288, e-mail bashkiadevoll@gmail.com.ëeb.http://bashkiadevoll.gov.al/